



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2022, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E ANEKS PLANIT TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA NË KOMUNËN E PRISHTINËS, 2021-2023

Neni 1

Miratohet Vendimi i Aneks Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, 2021-2023.

Neni 2

Aneksi i Planit i veprimit për personat me aftësi të kufizuara, i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është bazuar në Strategjinë nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, të vitit 2013.

Neni 3

Qëllimi i Aneksit të Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës, 2021-2023 është të mundësojë përfshirjen e problematikave të komunitetit të aftësisë së kufizuar në agjendat publike të zyrtarëve të Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Aneksi i Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës 2021-2023, Planit i veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës, 2021-2023 dhe komentet e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara për aneksin e planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-500/03-177554/22, më 26.07.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

